BEGZAT RRAHMANI

DJE DHE SOT

(POEZI SATIRIKE)

Shtëpia botuese
ASDRENI
SHKUP
1995

Biblioteka
XHA DERALLA

Redaktore
PUNTORIE ZIBA

Recensentë
FERIT RAMADANI
FADIL CURRI

Lektore
VJOLLCA RRAPI

Kukullat

Shikoja një vajzë të vogël
Që luante me kukull,
Një herë e bënte nuse
Pastaj e bënte sukull.

Hidhërohej çupa
Si bolshevik i vjetër,
Në vendin tënd i thoshte
Do të sjell një tjetër.

E shkreta s’ hapte gojën
Si i ndershmi shqiptar,
Për padronin i mirë
Për vetveten tradhtar...

I. PJATAT FLUTURUESE

Kukulla qeverie

Kolltuku i butë
Ka edhe KUNJ të fortë,
O burra mejdani
Politika s' është tortë.

Kokat bëni një
Si shpata e Skënderbeut,
Mendoni për popullin
Dhe kufijtë e Atdheut.

Mos luani me numrin
Si me gogla lotarie,
Deputetë Parlamenti
Kukulla Qeverie...

Kukudhët

Lindën kukudhë
Në Demokraci,
Edhe në varr
S’ do të kenë qetësi.

Njëri kërkon grekun
Tjetri Serbinë,
Popullin e harron
Veç në kolltuk të rrinë.

Habitet bota
Me këto kukudhë,
As serbi, as greku
S’ e kanë këtë udhë.

Hidhen e përdridhen
Si rrospi Stambolli,
Mallkohet ajo nënë
Që kukudhë polli...

Burrë me kule

Duhet të vdes
Inteligjencia debile,
Për interesat e vet
Kombit i ec me hile.

Lëshojnë mjekra
Ca qosa vetëm mustaqe,
Pispillosen mirë
Me erë manushaqe.

Turpërojnë Kombin
Dhe të bukurën lule,
Hiç s’ turpërohen
Veshin edhe kule.

Pëllasin para masës
Tamam si gomarë,
Shpallen heronj
Ndonëse jo të vrarë...

Llokma

Ca vite si mësues
Në fshat punoi hoxha,
Lamtumirë tha e falme
Edhe çallmën bile e dogja.

Se jam burrë partie
Komunizmi më fton,
Kjo që bëj unë
Në vesh të Titos shkon.

Sa ishte i lumtur
Atëherë poltroni,
Me gojën plot thoshte:
-“Kur’anin mos e besoni”.

Erdhi demokracia
Çallmën vuri në kokë,
-Ndryshoi, thotë-koha
Kemi të madhe llokmë...

Poltroni i kohës

I dëgjova kritikat
O mësues katundi,
Me poltronizmin tënd,
Përherë ke qenë përfundi.

S’ habiten edhe ato
E për mua është një lloj,
Unë jam satiriku
I pasur jo-por krijoj.

Jetoj me pensionin
Këtu ku jam autokton,
S’ më ha palla ç’ thotë
Ai që është poltron.

Adhuruesi yt prof. Madhi
Është poltron i kohës,
Të dyve s’ u ha palla për dijeni
Endeni lart e poshtë metropolës.

Ata që thoshin: s’ na duhet kjo
E s’ na duhet ajo,qenkan të mirë,
E ne krijues të kohës
Të ndjekur në zinxhirë...

Xhuxhmaxhuxhi me gunë

Monizmi i pagëzoi
Maqedonë mysliman,
E kurrkund në botë
S’ ka sllav ë Islam.

Këtë e bëri
Xhuxhmaxhuxhi me gunë,
U bë i pari
Përdorte edhe dhunë.

Por i iku koha
Ka mbetur fillikat,
E gjykojnë dashamirët
Për atë mëkat.

Euforia e xhuxhmaxhuxhit
I solli lezet,
Por si mendonte
S’ ka më xhenet...

Pjatat fluturuese

Vijnë na vizitojnë
Si pjata fluturuese,
Janë gojë ëmbël
Si të reje nuse.

Punët i dinë
Por si instruktor,
Tregojnë me gojë
Marrin me dorë.

Pastaj humbin
Diku në Galaktikë,
Për të zbuluar
Më të madh trik.

Kështu e kanë
Kameleonët politik,
Kur kanë interes
Armikun e bëjnë mik...

Dominuesi

Dikur në fshat
Na rrente një njeri,
Kokën në fshat
Bythën në qeveri.

Kishte pasuri
Dinte shkrim-lexim,
Për të mirë e të keqe
Vetë merrte vendim.

Tash kur u shkolluam
Sjell të tjera vendime,
Nëse s’ ka sukses
Ai gjen trillime...

Kuvendimi

U mblodhën një ditë
Kafshët në kuvend,
Pse i trazonin njerëzit
Vend e pa vend.

Ankoheshin ca kuaj
Që kishin dalë të bredhin,
I kishin kapur ca njerëz
Me qëllim ti tredhin

U ankuan demat
Na ushqejnë në verë,
Sa afrohet dimri
Thonë:”tash duhet therë”.

Folën shumë oratorë
Por s’ morën vendim,
I qetësoi gomar veshgjati
Që të kenë durim...

Funksionari

Dikur një funksionar
Ecte për mes çarshisë,
Populli pëshpëriste
Ja asqeri i Turqisë.

Bëri shumë dëme
Na ktheu prapa,
Tash duhej ecur
Me të shpejta hapa.

I perëndoi dielli
E ra nga piedestali,
I afrohet tash popullit
Ka peshë mali.

Një ditë në kafene
Arsyetohej ky funksionar,
Që dikur kundër shokut
Ka qenë dëshmitar...

Karrieristi

Shoku im shkencëtar
E meriton emrin akademik,
Kohëve të fundit është përtac
Shkencës disi i ik.

Rrogën e ka të mirë
Si në dimër, ashtu në verë,
Me sa biseda më habit
Mundohet shumë për karrierë.

Arsyen e gjen shpejt
Për shkencë duhej punë,
S’ mjafton dita-nata
Duhet kaluar pa gjumë...

Pyka shtyn pykën

Akoma shqiptarëve
Perdja s’ u ka plas,
Si flasin të tjerët
Përpara e pas.

Kjo është shenjë
Për të lartën kulturë,
Që të rrojnë
E jo të ndërtojnë mur.

Por koha e do
Perdja të plas,
Që të ndale ai
Që është mësuar të ngasë.

Një pedagog thotë”
“ Sillu me atë,
Siç sillet ai me ty”
Para pozicionit mat.

E populli thotë:
“Pyka shtyn pykën”,
Pasi meriton
Ktheja edhe tytën...

Përçajë e sundo

Dikur na ishte
Një Jugosllavi,
Nga republika e krahina
Nga kombe e kombësi.

Shumë vjet bashkim
Shumë vjet vëllazërim,
Shumë vjet punë
Shumë vjet armatim.

Peshku i madh
Të voglin e ha,
Kush ka forcë
Burrëri s' ka.

Shtriga e fortë
Por e madhe jo,
Përçajë e sundo
Gllabëro e gllabëro.

Tash e kuptoi
E tërë bota,
Por s' dihet kut
Do ti thyhet rrota...

II. DJE DHE SOT

Qafë për qafë me parinë

I freskonit
-komunizmit-
Ia ktheni prapanicën
-pluralizmit-.

U dekorojnë
U bëjnë shkrimtarë,
-recensentë-
Për marka e dollarë.

Për të njëjtat krijime
Dikur mendim zi e më zi,
Për vëllazërim-bashkim
Thoshit ky asgjë s' di!

Tash i greni në piedestal
I bëni: Naima, Migjena...
Ju shërbëtorë komunizmi
Jeta u shkoi me rrena.

Bastardoni gjuhën
Muzikën letërsinë,
Mjerë kombi
Qafë për qafë me Parinë...

Demokracia dhe monisti

E kuptoi demokracinë
Si martesën i pasuri plak,
Merr nusen e re
Dhe...në shtrat!

Shkohet në Evropë
Veç me demokraci,
‘Përpara” tha monisti
“pas me je rini”!

Kur nisën të zbatohen
Ligjet e demokracisë,
Prapë doli monisti:
“Jam unë zot i shtëpisë”.

S’ gënjehet bota
Me drejtësi në letër,
Tjetër rruga e monistit
Dhe e jona-tjetër!...

Qarku i hekurt

Te redaksitë ka ekzistuar
Qarku i hekurt kah mot,
Trashëgimtarët besnik
E ruajnë edhe sot.

Dorëshkrimet u humbin
Thaj se ato ecin,
E bëjnë me qëllim
Se vet pas ngecin.

U bllokon truri
Veç prej xhelozisë,
Prandaj ia bllokojnë rrugën
Prozës e poezisë.

O qark i hekurt
Me poltronë e lavire mjaft,
Abuzoni besimin
Rrënja e fara ju thaftë!...

Gjuha shkupjane

U shpall konkurs
Për administratorë,
Ta njohin gjuhë shkupjane
Dhe të jenë madhorë.

Ta kolonë Vardarin
Kur të ketë vërshime,
Me not e pa not
Në dasma e varrime.

Me shkollim të lartë
Për rrena e trillime,
Por jo të monizmit
Demokracia ka dallime.

Afati zgjat
Vetëm një ditë,
Një orë në punë
Gjithë jetën me Paritë...

Ngelëm të rinj

Dikur do pendohet
Edicioni shqiptar,
Për gabimet e bëra
Me poetë e shkrimtarë.

I ka botuar një rrethi
S’ themi se nuk kanë vlerë,
Por është dashur
Të mendojnë edhe për të tjerë.

Kemi ngelur të rinj
Në krijimtarinë kombëtare,
E tash për botime
Vërtetë duhen shumë pare.

S’ mund të ankohemi
Nga shtypi periodik,
E kemi pasuruar opusin
Por meritojnë kritikë...

Koka sot për sot

Dilni burra e dini gra
Bein ”Trumbetat e Tellallit”
Pas u shkon ‘Kali i Trojës”
Luftë bëhet rrëzë malit.

Parlamentarët vijnë kope
Të pispillosur, të nakatosur
Me shpata e kobure në brez
Nëpër foltore të armatosur.

Obobooo, do të dëgjojmë ligjëratë
Plot zjarr e premtime,
Për shkolla shqipe e flamur
Flakë më flakë nëpër dy luftime.

Qe edhe xhelati ynë- inatxhi
Satirikët i do në binë,
Kalosh Çelikun do ta shtjerrë në qeli
“Mi shkatërron nervat-lirinë”!

Vajtojnë pleq e plaka te jazi
Fëmijë, gra edhe burra,
Dridhet fusha, dyndet Zajazi
Në katër anë jep alarm “Gurra”!

Nga qielli vjen kurbani
Thotë:-poetët lini rehat,
I prijnë kombit i do vatani
E lum ai vend që i kaf!

Koka juaj vlen sot për sot
E të mjerëve vetëm katër vjet
Ata edhe pse shkojnë me lot
Veprat e tyre mbesin për jetë.

Ikni parlamentar pa kokë
Me bishtin nën shalë,
O popull, mos i besoni këta shokë
Atdheut i sulen me kalë...

Maniakët

Sa maniakë
Patriotë bëhen sot,
Me krime të shumta
Me radhë e ca mot.

Dikur u pengonte
Çdo gjë kombëtare,
Përzihen në popull
Hiç s' kanë marre.

Flasin si dikur
Janë orator,
S' mërziten për popull
Arën,që është korr.

Kërkojnë ndihmë nga ata
Që ua bënin me gisht,
Populli u thotë:
"kafshoni të juanin gisht"!

Dje dhe sot

Lum populli
Me këtë farë intelektuali,
E përdor Qeveria
Si kalë samari.

Lëvdohet me veshët
Që i ka të gjatë,
Gojë e dhëmbë
Për popullin shpatë.

Dje zot monizmit
Sot demokracisë,
Kështu thotë e kanë
Punët e qeverisë.

I përdor thotë mirë
Laps e çekiç unë,
Për ata që ngucen
Përdor edhe dhunë.

Me aftësi të kufizuara
Ka edhe të tjerë plot,
Të fëlliqur ishin dje
Beter janë edhe sot...

Don Kishoti ynë-donator

“ Pa dajën” thonë
S’ bëjmë kurrgjë”!
E daja jeton
Në perëndim
Për çdokënd
Daja jep mendim.

Na bën heronj
Pastaj tradhtar
Veç punët dajës
T’ i shkojnë mbarë.

Për një manifestim
Tradhtari u bë donator,
Sa shpejt dajën
E futi në dorë.

Dikush dajës t’i ofrojë
Post kryetari,
Vaj me det
Çdo të hekë shqiptari.

Daja ynë Don Kishot
Mjaft plak e Donzhuan,
Hiqe nga zemra vesi
Se më populli kështu se han...?!

Sharlatani

Lum populli
Me sharlatanin,
Në foltore
E mbron vatanin.

E kam trim
Zog me flatra,
Po kollite fort
Ik me të katra.

Pret momentin
Një fjalë ta shkrep,
Me punë të vogla
S' merret ai deputet.

"Ujë e bukë", thotë
Të kemi boll,
Ç'i duhet shqiptarit
Dijeni e shkollë"...?!

"Këtu kërkoni
Nga unë ç' të doni,
Si të shkoni në shtëpi
Të gjitha t' i harroni"...!

Kokëlegeni

Disa herë paraqitej
Me të njëjtin referat,
Në mbledhje partie
Dhe në sindikatë.

Disa mandate
I kalonte në gjumë,
Jini thoshte të lumtur
Si jam edhe unë.

Tash ti o monist
Që lëpihesh si viç,
I sheh padrejtësitë
S’ ke fuqi, shokë as miq.

Ata të shtynin
Të futën një gisht,
Çdo intelektual
I vendoje bisht.

Endu tash rrugëve
Tamam si qen,
Duart në xhep
Or kokë legen...

Çohu Stalin

Çohu Stalin
Ndali marritë,
Gabimet tuaja
Dikush përsërit.

Ia ndalin
Dikujt alfabetin,
E me dhunë
Ia imponojnë të vetin.

Pastaj thonë
“Kërkesë vullnetare”
Edhe këta si ti
Hiç s’ kanë marre.

Tridhjetegjashta
Kurrë s’ bëhet tridhjetë
Kryelartë ecin por
Zvarriten në kënetë...

Monisti i vjetër

“Shkojmë në pluralizëm
Dhe demokraci,
Por mbi të tëra
Unë do të rri.

I tha këto fjalë
Monisti i vjetër,
Gjuhën nepërkë
Këmbë e vesh lepur.

Si askush tjetër
Unë kam përvojë,
Mendoni mirë
Do të keni nevojë.

I shkreti monist
Ende na shet mend,
Edhe pse e diel
Se s’ ka më vend...

Kulltukxhiu

I pashëm e fodull
Ishte ai burrë,
Mandate me radhë
Nuk la të ulet tjetër kurrë.

Shpesh shikohej
Në pasqyrë fodulli,
Pastaj shtrihej
Sikur në lloç bualli.

Filloi të qelbej
Të ankohej në majasil,
Iu ndryshua pamja
Krejt u bë tebdil.

Shumë mirë kam qenë
Ç' është ky taksirat,
Cilat nëmë më zënë
Që më vunë në shtrat...?!

Termat

Ç’ u desh pluralizmi
Për ne shqiptarët,
S’ punonim gjë
E ishim të parit.

Sa i mësuam termat
Ist, ist, ist e ist,
Tash duhej të tjera
Terma pluralist.

Fituam autoritet, kur thamë:
-Turpërohemi që jemi shqiptarë,
Por s’ dimë as sot-
Për cilin u bëmë të parë?!

Një mandat merrnim rrogë
Si qumështi nga dhentë,
E tash do na ndalet
Mundet të luajmë mendsh.

Do ecim rrugëve
Sikur pa kokë miza,
Do të na bjerë vlera
Sikur në treg gjiza.

Deri dje në rrugë
Të gjithë na janë përkul,
Nesër kur të na takojnë
“Tungjatjeta o kokëtul”...

Shoku ministër

Profesor i gjuhës
Dhe ministër në kabinet,
I kupton mirë punët
Si dje edhe sot të shet.

Me popullin është i afërt
Edhe mito shumë ka marrë,
Përzemërsisht të përshëndet
E pas shpine të bën varr.

Me tespihe kuq e zi
Për konkurse e diferencim,
“Po të doli, thotë keq
Unë të paça në shpinë.

A ka më keq, shoku ministër
Se të mbetesh pa punë,
Të lusim përzemërsisht, shko
Në shpinë të paça unë...!

Shoku Rabera

Gjersa u bind bota
Se s’ jemi të egër,
Shumica u bënë
Copë e flegër.

Pastaj thoshin
“Se jemi me bisht”,
Pa augmente
Tregonin me gisht.

Pastaj e ngjitëm vetë
Irredentist-separatist
Shoku Rabera
Jemi vetëm karrierist...

Ca burra

Ca burra
Me lezet pinë kafe
Duke bërë pazarllëk
Njëri tjetrin ta largojnë qafe.

Bëhen e dhe armiq
E miq pasta,
Marifetëllëqe
Haj more haj.

U përgjigjen gazetarëve
Si në mejdan,
Flasin me vend e pa vend
Hiç palla s’ u hanë.

Në popull të marrin
Më shumë autoritet,
I kanë tollovit punët
S’ dinë kush cilin vret...

Kokëqeli

Dikur një bolshevik
Krejt kokën qel,
I dinte referatet
Përmendësh si gjel.

Kur dilte në foltore
Kruante hundë e kokë,
Shikonte nga të gjithë
T' i bënte si shokë.

Por ata kishin mbushur
Kokat plot mend,
Ia bënin me sy e kokë
Që të shkojë në vend.

I thoshin "na perëndoi dielli
Neve në mesditë,
Ta lëshojmë me vendin
Le të vijnë të rinjtë.

Por s' bindej kokëqeli
Si në urë gomari,
Ishte mësuar me dallavere
Të jetë përherë i pari...

Epiteti

Ata që s’ ngarendin
Të mbarojnë fakultet,
Ngarendin të mjerët
Të marrin epitet.

Por ka edhe nga ata
Si e kryen fakultetin,
Ashtu morën
Edhe epitetin.

U bënë të ndershëm
Duke bërë mriz,
Duke thënë larg bythën
E larg timin kurriz.

Rrinin nëpër zyra
Me lepur në bark,
Për të vetët ishin top
Për të huajt hark.

Le ta dinë ata
Që e pranuan këtë epitet,
Do të jenë të huaj
Edhe në shtëpinë e vet...

S’ më dolën para

S’ mërzitem pse vdiqa
Por se ngela mbi tokë,
Mos mendoni hero
O të dashur shokë.

Kortezhin e shikoja
Nja shtatë-tetë veta,
Tash e kuptova
Ç’ kam pasur të meta.

Hanin pinin e luanin
Sa dridhej toka,
E unë se kisha vdekur
Hiç s’ u dhimbej koka.

Ma përmendnin emrin
Krejt me ironi,
Jo vetëm të rriturit
Por edhe fëmijë.

Edhe miqtë këtu
S’ më dolën përpara,
E njërin e dëgjova tha:
“Këtyre duket shuar fara”...?!

Elita Kërçovare

Në kafenenë “Elita”
Lëvdohej elita pa sens,
Ryshfetin që kishin dhënë
E dinin për mëndësh.

Njëri u thoshte
“Katër vjet jam drejtor,
Për një magnetofon dhe
Bardh e zi televizor”.

Tjetri edhe më trash
“ Unë dhjetë vjet jam drejtor,
Në një tetëvjeçare
Për një video e TV kolor”.

E i treti radhiti funksione
Që mbajti mbi shpinë si gomar,
“ Pasi s’ kishte vëlla në perëndim
Për çdo vjet kam shitur nga një arë”.

E i katërti s’ kishte ç’ të thotë
S’ ka pasur asnjë funksion,
Veç t’i shkruante këto vargje
Në “ Elitë “ që i dëgjon...

III. NË ZYRË TE UNË

Në valët e radios

Shqiptari i ndershëm
Mendonte për bumin,
Pa emër e mbiemër
Fliste për referendumin.

Në valët e radios
E jo në foltore,
Ndiente kënaqësi
Sikur në nevojtore.

Ai farë demokrati
Kokën gropa-gropa,
S’ e do më familja
E ku më Evropa.

Tha, “Presim kohën
Prapë të na vijë,
E të bëjmë
Zi e më zi”.

O shqiptarë i ndershëm
Ti or satrap,
Mbytu te shurra e pulës
S’ kthehet koha prapë.

Në vend djali

Shumë vjet në shtëpi
Isha burrë e grua,
Vjehrri bolshevik
Shumë më ka munduar.

Mos ia rreh të bijën
Bile mos ia shajë,
Se dreqi i zi,thoshte
Do të më hajë.

Duro thash, duro
O antikomunist,
Po e çove kokën
Të bëri separatist.

E tash i shkreti
Kur ra nga piedestali,
Thotë shumë herë:
“ Të kam në vend djali”.

S’ shlyhet ajo bojë

Dikur flisja
Shumë me këtë gojë,
Sot e mbaj të mbyllur
Por s’ shlyhej ajo bojë.

Këto duar kanë punuar shumë
Gojën mbushin plot mish,
E tash s’ më besohet më
Kur s’ ka pula të bëjë ish...

Ti erdhe në rend

Një lepur vesh gjatë
S’ kishte edukatë e mend,
Shoqërohej ai me ujq
S’ mendonte se do të vijë në rend.

Kishte dalë një ditë
Veshgjati me porosi,
Kaloi nëpër një arë me lakra
Duke mos ditur se kishte pusi.

Do ujq të uritur
E futën atë në mes,
Filluan të luajnë
Lëmshi sikur në thes.

U tregoi si qëndron puna
Por pesë pare s’ i bëri rixhaja,
Pritnin momentin ti vërsulen
Se e shijshme do të ishte haja.

Kur njëri ia këputi bishtin
U bërtiti: “ A jeni në mend”,
-Pasi s’ kemi tjetër gjah
Ti erdhe në rend...

S’ mi merrnin me zor

Aty nga mesi i natës
di[ç më ra ndërmend,
t’ i shes arat e babës
të tëra me rend.

Të blejë një veturë
T’ i bëjë pak deviza,
Të kem një vilë në det
Të mos di ç’ është kriza.

Vilën ma hëngri vetura
Devizat i gëlltitën kateterit,
Isha atë kohë i lumtur
Tash s’ më qasin as kinkaleritë.

Gabimi është i madh
Por s’ mi merrnin me zor
Jam bërë trillan
Sukses s’ jam duke korr...

Asnjëra nga zemra s’ më del

Janë ca studente
Rrinë përherë në hotel,
Pinë konjak me shumë yje
Asnjëra prej zemre s’ më del.

Njëra është e hollë e gjatë
Tjetra e shkurtër e trashë,
Të gjitha janë të bukura
Këmbë e krye t’ i hash.

Kanë ca probleme
Me të shkreti studim,
Profesorët kërkojnë dijeni
Me gojë dhe me shkrim.

Studentet ja të gatshme
Punës t’i hynë menjëherë,
Veç përpara profesorit
Të mos dalin edhe njëherë...

Në zyrë tek unë

Tymi i cigares
Si shtëllungë leshi,
Buzët e shëmtonin damën
Si macen kur e djeg përsheshi.

Plaku shumë vjeçar
Kërkonte një vërtetim,
Dama iu përgjigj rreptë:
-S' bënë tash kam pushim".

"Bukur vajza ime
Por tash është kohë për punë,
"Plak s' jam unë në zyrë teti,
Por ti je në zyrë tek unë".

Më mirë plak shko
Je shumë i vjetër,
Vërtetimi kërkon sjellje
Eja një ditë tjetër.

Plaku i habitur
U nis nga dera,
Kish frikë nga dama
E thumboi si ferra...

Sjellja pa edukatë

‘E h mori grua, grindemi
Sikur të ishim grindavecë,
E ke skuqur fytyrën
Si djegës spec”.

“ S jelja jote
Hiç pa edukatë,
Fajëson prindërit e mi
Por më shumë gratë”.

Thau të kesh shtëpinë
Të veçantë në disa kate,
I hedh fjalët e ndyra
Pa mos i matur fare...

Fodullja e nënës

E ka nëna
Këtë cucë fodulle,
Është shumë e bukur
I vjen era lule.

E kam mësuar
Shkruan në makinë,
Sa zbardh dita
Shkuesit varg vinë.

Ma lypin mjekë
Inxhinierë plot,
E kemi të re themi
S' e japim këtë mot.

Punon në komunë
Afër njëzet vjet,
Çfarë ere e bukur
Paramendoni vet.

Mundohej të bindi
Nëna një nënë,
Të shpëtojë nga fodullja
Që derën ua ka zënë...

Llafazanet

Moderne na qenkan gratë
Që pinë duhan e kafe,
Dhe për një minutë
I thonë nj mijë llafe.

Për asgjë
s' u ha palla,
flasin për kolege
për teze e halla.

Për veten mendojnë
Asgjë s' u mungon,
Veç nga pakë
Koka i mundon...

Nga pushimet verore

Ulqini do të ishte mrekulli
Të mos kishte miza,
Dhe të mos kishin përparësi
Ata që kanë deviza.

Turisti i vendit
Në dert është i shkreti,
Prej këtij halli
Rëndë afrohet te deti.

E shërojnë reumën
Në arë duke korr,
Se për të gjetur deviza
E kanë shumë zor...

Haxhi dreqi

Në katund kemi
Një dreq haxhi,
S’ e ndal bora
As i madhi shi.

Në xhep mban
Shumë gazeta,
Thotë se di
Sa një mijë veta.

Përzihet në fe
Shkencë e politikë,
Me meze të mirë
Pinë edhe mastikë...

Miza pa kokë

Dikush kërkon
Roje personale,
Për t’ i kryer punët
Paska shumë halle.

Shuhet se ka frikë,
Ai farë burri,
Me roje personale
Do të jetë i fort si guri.

Kush përlyen duar
Me atë të helmuar gjak,
Nga hija e vet
Zhduket përditë nga pak.

Kur del në foltore
Si miza pa kokë,
I ka humbur miqtë
S’ ka më as shokë...

Mustaqet e zeza

Baba plak
ishte mustaqezi,
Gjersa ishte gjallë
Kishte rend në shtëpi.

Urdhrat që jepeshin në mbrëmje
Në mëngjes s' kishin përmirësim,
Punohej tërë ditës
Edhe ai punonte pa pushim.

Shtëpia ishte plot
Veshmbathja s' mungonte kurrë,
Edhe për shkollim s' kishte problem
Dihej kush ishte grua e kush burrë.

Vdiq plaku i mençur
U zhdukën mustaqet e zeza,
Të mësuarit e kësaj shtëpie
S' punojnë fare, vetëm japin teza...

Punëtori me sidë

Një mjek faqezi
Pasi kishte lënë mjekër,
Punonte me intervenime,
Thoshte: “Ec një ditë tjetër”.

Një punëtori i dhembte prapanica
Kishte ra drejt në një vidë,
Pasi dëgjoi, mjeku bërtiti
“Largohu, ajo sëmundje quhet “ SIDË”.

Duhej ditë shoku mjek
Sida është e atyre, që kanë para,
Sëmundje e perëndimit
E atyre që s’ duan gra.

E dinte shoku mjek
Se punëtori ishte shqiptar,
Për një grua të mirë
E shet më të madhen arë...

S’ i zihej besë

Një natë vonë
Ktheva në tombolë,
Pash një njeri
Të rrezikshëm si bollë.

Kishte humbur shumë
Prandaj ishte hidhëruar,
Të nesërmen thoshte
Ka për të fituar.

Kur vajti në shtëpi
I kishte ardhur një shkresë,
E lexoi disa herë,
Por si zihej besë.

E kishin bërë të madh
Si veshgjatin me shalë,
A është e vërtetë
Apo dikush më tallë?!

Lumë unë e lumë vendi
Do të tregohem burrë,
Që në këtë nën qiell
S’ mbahej mend kurrë...

Miq për fiq

Dikur një mik
Më bëri drejtor,
E shpërbleva
Me një televizor.

Mandatin e dytë
Të hapur e kisha derën,
I dhashë do filma
Me gjithë kamerën.

Sa herë shkoj te miku
Më fut në dhomë speciale
Pimë uiski-
E qajmë shumë halle.

Sa të jetë gjallë
Do të jem i pari,
Ai mos mërzitet
Për marka e dollarë.

Pra ne jemi
MIQ PËR FIQ
Jo vetëm vetveten,
Por tërë botën kemi fëlliq...

Egoisti

Një njeri i qytetit
Nisi të mbajë ligjërata,
S’ kishte kujdes ç’ fliste
Goja i priste si shpata.

Pasi u lodh dikur shumë
Nisi të shajë edhe Zotin,
Pse bënte shumë nxehtë
Pse se freskonte motin.

Jetën deshi ta ketë rehat
Xhepat plot para- deviza,
Për të tjerët s’ interesohej
Ai mos ndihej ç’ është kriza...

Çdo ndjenjë iu fik

Nga fshati atje
Që është rrëzë malit,
E mbaroi fakultetin
I mësuesit djali.

Shpejt u punësua
E u bë bolshevik,
E harroi fshatin
E çdo ndjenjë iu fik.

U armatos mirë
E i la mahitë,
Mësoi tabiatin e zagarëve
Të gjuajë natë e ditë.

Gjuante kafshë të buta
E të egra thoshte,
Ia paguanin shtrenjtë
Lëkurën kur ua çonte.

Më herët i perëndoi dielli
Se sa kishte menduar
Tash rrugëve të qytetit
Ecën si i hutuar.

Zemërkeqi

S’ la gjë pa bërë
Një zemër keq,
Gjersa gjente rrugë
Bëhej lavire e dreq.

Si iu rritën fëmijët
Iu kthye rrota,
Mik se bënte njeri
E kishte matur mirë bota.

Djali më i mirë
Iu vra në aksident,
Vajzën ia la burri
Për të mëdha mend.

Vetëm do të dashur
I shkuan në varrim,
Atëherë zemër keqi
Pa se kishte bërë gabim...

Tash jam zotëri

Pesë vjet studime
Aty në fakultet,
Dhe po aq vjet pune
Unë si arkitekt.

Bëra gardërobë
Ashtu sipas modës,
Bleva një krevat
Për në skaj të odës.

Me nj shok nga fillorja
Që i thoshim analfabet,
Si shok klase, pimë nga një kafe
Dhe më mori në kurbet.

Hapnim do kanale
Të thella disa kat,
U mbusha plot deviza
Për një vit bëra pallat.

Dallaveraxhiu

Jam shumë i lumtur
Që bleva një përlak,
Por hidhërohem pse fqinjë
Djalit i bleu kadillak.

Flitet se vjet në dimër
Ka bërë një dallavere,
Por s’ është ndalur
As kësaj vere.

Punëson jo punëtor
Blen e shet deviza,
Thotë me shat e laps
S’ hiqet nga koka kriza...

Përgëzimi

I përgëzoj
Ata shqiptarë,
Që janë në pozita
Ose kryetarë.

Por vetëm ata
Që janë treguar me aftësitë,
E jo pse duhej qenë
Ndonjë nga kombësitë.

Prej atyre tjerëve
Ne kemi plot,
Që s ‘ kanë thënë fjalë
As dje as sot.

Njëri nga ato shqiptarë
Gjatë kohë funksionar,
I nxori rrënjët mbi tokë
Tash rri sikur varë.

Djali i mësonte mirë
E la veç me tetëvjeçare,
Shko i tha në Amerikë
Babës i duhen pare...

Kastraveci

Trupshkurtër
Barkun kosh,
Hanë shumë
Kokën bosh.

Në rreth ka
Shokë shumë,
Pinë kafe
Me shumë rum.

Lëvdohet
Se është burrë,
Por burrëri
S’ ka treguar kurrë.

Sikur ta njihni
Këtë kastravec,
Do të bindeni
Se është mistrec...

Fshati im

S’ është si ai i Çajupit
Por ka xhami e varre,
Shtëpi të mëdha
Plot deviza e pare.

Ka asi burrash
Që s’ bëjnë punë,
Hanë bukën e gruas
Ndër ta jam edhe unë...

Brengosja

Fëmijët shkojnë në shkollë
Gruaja shkon në punë,
Paradite në shtëpi
Rrimë Yllëza dhe unë.

Bisedojmë si fëmijë
Por edhe si të rritur,
Bën pyetje Yllëza e vogël
Që kurrë si kam pritur.

Kur do të rritesh babi
Të shkosh edhe ti në punë,
Pasi afrohet koha
Në shkollë të shkoj edhe unë...?!

Shokët

Kam një shok
Farkëtar-
Përherë punët
I shkojnë mbarë.

Përditë pare
Jep e merr,
E ka shtëpinë
Krejt mermer.

Një tjetër kam
Poet i thonë,
Shtëpi ka-
Me qira një dhomë.

Një tjetër me diviza
Bënë tregti,
Ka mercedes
Vilë e shtëpi...

Allah, allah

Allah, allah
Çfarë kohe ka ardhë,
S’ ka shije molla
As më e mira dardhë.

Dikur kënaqeshim
Nëpër dhoma me muhabet,
Sot nga ajo kohë
Kurrgjë s’ ka mbet.

Sot s’ vjen kush në rend
Diçka për të treguar,
Na rrëmbeu televizori
Me filma të vizatuar...

Dikur kishte rend

Dikur kishte rend
Përpara bëhej fejesa,
Kalonin disa vjet
Pastaj edhe martesa.

Para se të bëhej një vit
Lindte vajzë apo djalë,
Gëzohej e tërë familja
Edhe zogjtë në mal.

Tash punët janë ndryshe
Vdiq edhe tezja Zize,
Për lindjen e fëmijës
I jepnin një rize,

Gjinekologut i japin deviza
Fëmijën t' ua ndjek fati,
Që u shpëtoi vajzën
S' ka rëndësi kush është i ati...

IV. PAPAAAA - NË SHTËPI

Papaaa-në shtëpi

Në mes të sheshit
U paraqit deputeti,
Nga hidhërimi
Buçiste qyteti.

Punojmë për popull
Sa edhe ujë s' pimë,
Hijeshohet parlamenti
Aty që rrimë.

Ç' bënë të parit
Të bëjmë ne - unë,
Përveç rrogës
S' mundemi më shumë.

Ç' keni deputet
Kështu që bërtisni,
Ne ju bëjmë kritika
E ju na ndiqni.

Nuk dilet në foltore
Me rrena të thata,
Kur pini e hani
Pa kripë sallata.

Ku i kemi shkollat
Ku është punësimi,
Veç me rrogat tuaja
Arrihet barazimi?

Meritoni kritika
Se u kanë lëpi,
Thoni si fëmijët papaaa
E hajeni në shtëpi...

Përmbajtja

Kukulla.....5
I. PJATAT FLUTURUESE
Kukulla qeverie.....6
Kukudhët.....7
Burrë me kule.....8
Llokma.....9
Poltroni i kohës.....10
Xhuxhmaxhuxhi.....11
Pjatat fluturuese.....12
Dominuesi.....13
Kuvendimi.....14
Funksionari.....15
Karrieristi.....16
Pyka shtyn pykën.....17
Përçajë e sundo.....18
II. DJE DHE SOT
Qafë për qafe me parinë.....19
Demokracia dhe monisti.....20
Qarku i hekurt.....21
Gjuha shkupjane.....22
Ngelëm të rinj.....23
Kokat sot për sot.....24
Maniakët.....26
Dje dhe sot.....27
Don Kishoti ynë donator.....28
Sharlatani.....29
Kokëlegeni.....30
Çohu Stalin.....31
Monisti i vjetër.....32
Kolltukëxhiu.....33
Termat.....34
Shoku ministër.....36
Shoku Rabera 37
Ca burra.....38
Kokëqeli.....39
Epiteti.....40
S' më dolën përpara.....41
Elita Kërçovare.....42
III. NË ZYRË TEK UNË
Në valët e radios.....43
Në vend djali.....44
S' shlyhet ajo bojë.....45
T' i erdhe në rend.....46

S’ mi merrnin me zor.....47
Asnjëra nga zemra s’ më del.....48
Në zyrë tek unë.....49
Sjellje pa edukatë.....50
Fodullja e nënës.....51
Llafazanet.....52
Nga pushimet verore.....53
Haxhi ndreqi.....54
Mizë pa kokë.....55
Mustaqet e zeza.....56
Punëtori me sidë.....57
S’i zihej besë.....58
Miq për fiq.....59
Egoisti.....60
Çdo ndjenjë iu fik.....61
Zemërkeqi.....62
Tash jam zotëri.....63
Dallaveraxhiu.....64
Përgëzimi.....65
Kastraveci.....66
Fshati im.....67
Brengosja.....68
Shokët.....69
Allah, allah.....70
Dikur kishte rend.....71
IV. PAPAAA- NË SHTËOI
Papaaa në shtëpi.....72
Shënim për autorin.....74

Begzat Rrahmani- Dje dhe sot
Botuesi-shtëpia gazetare-botuese ASDRENI
Për botuesin-FATMIRA ÇELIKU, drejtor
Korrektor-LAURA ÇUKA
Realizimi kompjuterik-DRILASOFT
TIRAZHI 1000 copë